



 REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 2-180/8051
 Nr. i faq. 5
 Data 01/09/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 07-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	28.07.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së shtatë (7) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.07.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marim pjesë të 12 anëtarëve të kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj. Leunora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Xhavit Velijaj DAKRS, z. Fatos Shala-DSHMS dhe z. Zenun Shala DUKM

Anëtarët prezent

- | | |
|--|--|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar, LDK
5. Ermelinda Lolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK (Mungoj) | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK (Mungoj)
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV (Mungoj)
14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
|--|--|

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Raporti rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën janar-qeshor 2023,
3. Raport i punës të kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Qeshor 2023,
4. Raporti i auditimit për vitin 2022 dhe plani i veprimit,
5. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2022/2023,
6. Miratimi i Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Junikut 2023-2025,
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjetër nuk ka lidhur me rendin e ditës, para se ta hedhi ne votim konstatoi se prezen ne salle jane 10 anëtrët e kuvendit, kush është për këtë rend te ditës, për 10 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoj se rendi i ditës u miratua.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, z.Zenel Maloku na ka njoftuar se do te vonohet për këtë mbledhje, z.Lulzim Gacaferi na ka njoftuar se nuk do te marr pjese ne këtë mbledhje, ndërsa për te tjerët nuk kam informate.

2. Raporti rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën janar-qeshor 2023,

Raportimin dhe arsyetimin lidhur me gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën janar-Qeshor 2023, e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoresh ne DBF, e cila fillimisht i pershendeti te gjithë me me pas e sqaroi raportin para anëtarëve te kuvendit.

Gjate keti raportimit mbledhjes se kuvendit i bashkëngjiten edhe dy anëtarët e kuvendit, z.Zenel Maloku dhe z.Leonard Lllolluni.

z.Leonard Lllolluni, përshëndetje për te gjithë, unë i ka disa pyetje, ajo qe me shqetëson është shpenzimet për udhëtim jashtë shtetit, për një komunë te vogël si komuna e Junikut në shumë prej 5139.80€, përpos kësaj është marr edhe avans për udhëtim ne vlerë prej 2480€, dua te di se per çka jane shpenzuar dhe për cilat udhëtime behet fjale, pastaj te shpenzimet e telefonit, 2547€ dhe çka eshte shqetsuse shpenzimet për shërbimet e avokaturës 4194€, ndërsa te shërbimit tjera kontratuese kisha dashtur te di se për çka behet fjale sepse ne raport e kemi vetëm si shume te paraqitur ne shume prej 18301€, mandej kemi drekat zyrtare ne shume prej 1988€, për te gjitha keto qeshje qe i ngrita kisha dashtur te kemi sqarim me te hollësishëm.

znj. Vjollca Qestaj, për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit behte fjale për udhëtimet qe kane qene publike, udhëtime këto qe janë bere nga Kryetari dhe kabineti i tij, udhëtimet kane qene ne Gjermani , ne ketë udhëtim kemi qene Kryetari me staf dhe udhëtimet tjera kanë qene ne SHBA saksisht ne Ajova, janë shpenzime te arsyeshme dhe nuk e kanë kaluar limitin e planifikimeve, ndërsa për anvanse, avansi është marë për këto udhëtime. për shpenzimet e telefonit ne kemi kontratë me operatorin Vala, dhe shumica e zyrtarëve janë brenda ofertës se kësaj kontrate që kane numër te operatorit Vala, dhe po ashtu edhe këto shpenzime nuk e kalojnë planifikimin, shpenzimet per shërbimet e avokaturës ne kemi një kontrate dhe shpenzimet bëhen sipas specifikatve te asaj kontrate, ndërsa sa i përket shpenzimeve tjera kontraktuese mund te pergjigjem per do qe i di por edhe këto shpenzime janë brenda planifikimit.

z.Arten Hamza, sa i përket shpenzimeve shërbimeve kontraktuese, ne kuadër kësaj kategorije jane shërbimet e printimit ne shume 593€ qe janë te shpërndara neper drejtori, transporti i nxensave ne shume prej 6782€, punët e projektimit ne shume prej 2485€, punët gjeodezike 4253€, mirëmbajtja e ndriçimit publik 3070€ , është një leje ujore nga ministria e mjedisit si dhe një fatur ne shume prej 77€ për shërbime spitalore. agjisi i mjeteve qe behet ne QKMF.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për te gjithë, sa i përket shpenzimeve për udhëtime jashtë shteti, ju e dini se ne kemi dy vendime te binjakzimit te komunes tone me dy komuna, si dhe është një udhetim i ministris per pushtein lolal ku kemi qene gjashte kryetar komuna ne ketë udhëtim dhe per kete eshte bere terhekja e avansit si dhe biletat e udhëtimit janë te kontraktuara ne nivel qendror, mire por shpenzimet i kemi bartur ne, udhëtimet kanë qene ne qytetin e Ajoves, Nju Jork si dhe ne qytetin e Klarionit qe jemi binjakëzuar këto udhëtime kane zgjatur shate dite ne total, ndersa pjesa tjetër është nje udhëtim prej katër vetëve ku kam qene unë si Kryetar i Komunës se Junikut dhe tre veta te tjerë dhe udhëtim ka qenë ne shtetin e Gjermanisë ku kemi një binjakëzim një komune, shpenzimet janë brenda planifikimit për ketë kategori.

z.Leonard Lllolluni, arsyeja se pyeta lidhur me shpenzimet për jashtë shtetin ishte se ne kohen kur unë sa isha drejtor ne Drejtorinë për zhvillime ekonomik, me akuzonin se po beje shpenzime për udhëtime jashtë shteti edhe pse unë as një cent nuk e kame mare nga komuna për këto udhëtime sepse shpenzimet i kam pasur nga donatori Japonez.

3. Raport i punës të kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën janar-qershor 2023,

Raportimin e beri z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës se Junikut, i cili pasi qe i përshëndeti edhe një here te gjithë, e arsyetoj raportin e punës të kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën janar-qershor 2023, para anëtarëve te kuvendit.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, unë e përgëzoj Kryetarin e Komunës për ketë raport pune, me shprese qe ne raportin e radhës te kemi shpenzime edhe për projekte kapitale, po ashtu e falënderoj qe është i rregullt ne pjesëmarrjen e mbledhjeve te kuvendit.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për te gjithë, gjate raportimit te kryetarit u përmend, ndërtimi i urës ne fshatin Jasiq, dhe mua me intereson se a do te hiqet laura qe gjendet afër urës ne atë

pjese, apo do ta lejoni prap te qëndroj aty ku është, dhe se sipas mendimit time nëse nuk hiqet do te jete pengesë e madhe.

z.Ruzhdi Shehu, ne do ti shikojmë mundësit qe ne bashkëpunim me zyrën e parkut nacional qe ta lëvizim atë laurë sepse aty ku është pengon ne qasjen ne ruge sepse është shume afër dhe besoj se do te gjejme nje vend ku do te jete e përshtatshme vendosja e kësaj laure.

4 Raporti i auditimit për vitin 2022 dhe plani i veprimit,

Raportimin e auditimit për vitin 2022 dhe plani i veprimit, e beri z.Arten Hamza, zyrtar i Lartë për Financa ne DBF.

z.Leonard Lolluni, është shqetësuese kjo gjetja e re, menaxhimi i kontratave dhe kjo nuk është gjetje e thjeshtë por është e rëndësishme sepse pikërisht këtu ndodhin keqpërdorimet ne sistemi e-prokurimi, per shkatë se ndodhin ndryshimet ne kontrata dhe menaxheri i kontratës është përgjegjës për ato ndryshime, dhe e ardhur si e gjetur e re është për shkak te mos transparencës ne këto ndryshime, dhe është e gjetur shume serioze, ne faqen 10 thotë se ne vitin 2022 komuna e Junikut ka shpenzuar 88% te buxhetit final ose 1683436 € me një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2021, edhe kjo është shqetësuese.

z.Sadri Krasniqi, unë e përgëzoj Kryetarin dhe Drejtorët për punën e bërë sepse ka vetëm një gjetje siç është kjo menaxhimi i kontratave e thamë këtë me një arsyeje, sepse auditimi i viti te kaluar ka patur shume te gjetura për këtë arsyeje ju përgëzoj me shprese qe ne auditimin e radhës t mos jene as këto te gjetura.

5. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2022/2023,

Informaten e beri z.Xhavit Velijaj, drejtor ne DAKRS, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas i informoj anëtarët e Kuvendit lidhur me përfundimin e viti shkollor 2022/2023.

z.Leonard Lolluni, rezultati qe u prezantua nga drejtori me gëzona, por ne te njëjtën kohe me shqetëson sepse nga klasa e pare e deri ne te nëntën nuk kemi as një nxënës me një njish, dhe mendoj se kjo do të na kushtojë ne te ardhmen sepse është e pa mundur qe te mos ketë një nxënës me një njish, ne i dimë se ka nxënës te dobët ne shkollë dhe ne ketë mënyrë se si po i kalojmë ne jemi duke i marrë ne “qafe” këta nxënës, plus jemi duke i barazuar me ata nxënës qe angazhohen te mësojnë dhe ne fund te dyja palët po e kalojnë vitin, dhe kam edhe një çështje, çështja ka te beje me pozitën e sekretarit te shkollës, kemi pasur dy konkurse te hapur dhe u paten anuluar dhe drejtori mu pat përgjigjur se ajo pozitë do te shuhet sepse kemi pak nxënës dhe i pata thënë drejtor kujdes ne deklarata se nuk e harroje, dhe tash për herën e tretë hap konkursi është përzgjedhur sekretari i shkollës, mire se është përzgjedhur dhe për çudi ky sekretar ne test me shkrim ka dalur me mirë se ata personat qe kanë magjistruar, dhe tani i bije se ky është si këta qe e ceka me herët një njish me i mirë se pesëshi ose këtu ka një dallavere.

z.Ruzhdi Shehu, gjendja e suksesit është ashtu siç u prezantua, por ne mund te themi se duhet te behet nje vlerësim i personelit, dhe tani është një insititut, enti për arsim qe do te bëjë vlerësimin e personelit te shkollës dhe ne po besojmë qe me inspektimin e këtij enti do te rritet kualiteti i

mësimit edhe në shkollat tona, ata do të monitorojnë arsimin dhe në baze të kësaj do të ketë edhe rekomandime se a ka mësues të dobët, ndërsa sa i përket sekretarit të shkollës, ligji e thotë se kur ke me pake se 500 nxënës ajo shkollë nuk ka nevojë për sekretar, dhe tani pas hapjes së konkursit unë nuk do ta vlerësoj se si ka shkuar sepse kemi pasur një komision përzgjedhës të “pa varur” dhe ky është rezultati.

z.Zenel Maloku, unë e përgëzoj drejtorin për këtë punë që është duke u bërë, sepse në kohën kur unë isha nxënës ka pasur nxënës, që ka pasur 11 njisha.

6. Miratimi i Planit Komunal për Ri Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Junikut 2023-2025,

Arsyetimin dhe sqarimin në emër të grupit të punës e bëri znj. Leonora Shehu drejtoresh e DAP, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë dhe më pas e sqaroi dhe e arsyetoj Planit Komunal për Ri - Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Junikut 2023-2025, para anëtarëve të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, para se ta qes në votim, Planit Komunal për Ri Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Junikut 2023-2025, konstatoi se në sallë prezent janë 10 anëtarët e kuvendit, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota konstatoi se plani komunal për ri- integrim u miratua.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.


z.Zenel Maloku, ajo që mua po më intereson është se ku do të hapet një rrugë fushore, dhe po ashtu po më intereson, ura që është u ndërtuar në qafë të Jasiqit, në atë urë janë planifikuar që të futen 28 tonë hekur, sipas drejtorit të urbanizimi i cili ma ka thënë me herët këtë, dhe tani mua po më intereson sa beton do të futet në këtë urë.

z.Ruzhdi Shehu, rruga fushore është në lagjen Qestaj.

z.Zenun Shala, përshëndetje për të gjithë, është e vërtetë se në si drejtori e kemi bërë përgatitjen e projekti për ndërtimin e urës në qafë të Jasiqit, bashkë me të kemi bërë edhe përshkrimin teknik të udhëzimit të ecurive të punës se si me vepruar, dhe aty parashihen të futen 342 kub beton.

z.Shpejtim Gacaferi, më qene se sot është dita e rënies së tre Dëshmorëve të Kombit të Luftës së Fundit: Dëshmori Shlezen Gacaferi, Dëshmori Avdyll Jasiqi, dhe Dëshmori Arif Gjocaj, për ti nderuar këta tre dëshmorë, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje-nderim. LAVDI me kaq e shpalli të mbyllur mbledhjen e korrikut 2023.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha


Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

